



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:029128
Datë: 24.02.2025
Numri i dokumentit: 06889279

C. nr. 526/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, nëpërmjet gjyqtarit Atdhe Berisha, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional L.Ç. në çështjen juridike të paditësve S.G. me numër personal V.J. me numër personal V.Sh. me numër personal V.B.1. me numër personal V.B.2. me numër personal V.S. me numër personal dhe Xh.H. me numër personal të cilët me autorizim i përfaqëson avokat B.Gj. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në pagë konform licencimit – kualifikimit, gjykata me datë 24.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit V.J. ndërsa pjesërisht e paditësve S.G., V.Sh., V.B.1., V.B.2., V.S., dhe Xh.H. me të cilën kanë kërkuar kompensimin e pagës në emër të kualifikimit – licencimit, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të kompensimit në pagë konform licencimit – kualifikimit të paguajë shumat dhe atë:

- Për paditësen S.G. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro;
- Për paditësin V.J. për periudhën kohore 01.12.2020-18.04.2021, për 27% të të pagës bazë (421) euro, shumën prej 283.35 euro;
- Për paditësen V.Sh. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro;
- Për paditësen V.B.1. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro;
- Për paditësen V.B.2. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro;
- Për paditësen V.S. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro;
- Për paditësen Xh.H. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 8,586.25 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë (14.02.2022), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve dhe atë për paditësen S.G. për periudhën 02.10.2017 - 14.02.2019, në shumën prej 1,188.51 euro, për paditësen V.Sh. për periudhën kohore 18.04.2017 - 14.02.2019, shumën prej 1,389.16 euro, për paditësen V.B.1., për periudhën kohore 18.04.2017 - 14.02.2019, shumën prej 1,458.25 euro, për paditësen V.B.2., për periudhën kohore 04.10.2018 - 14.02.2019, shumën prej 419.52 euro, për paditësen V.S. për periudhën kohore 18.04.2017 - 14.02.2019, shumën prej 1,459.72 euro dhe për paditësen Xh.H. për periudhën kohore 18.04.2017 - 14.02.2019, shumën prej 1,524.89 euro, si të parashkruar.

III. OBLIGOHET e paditura Komuna e Prizrenit, që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 412 euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Arsyetim

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate me 14.02.2022, kanë parashtruar padi me numër C.nr.526/22, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën kanë kërkuar kompensim në pagë, lidhur me kualifikimin – licencimin, për periudhën kohore 2017 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë në emër të diferencës së papaguar, për paditësen S.G., shumën prej 2,572.26 euro, për paditësin V.J., shumën prej 283.35 euro, për paditësin V.Sh. shumën prej 2,772.91 euro, për paditësin V.B.1., shumën prej 2.842 euro, për paditësin V.B.2., shumën prej 1,803.27 euro, për paditësen V.S. shumën prej 2,843.47 euro, për paditësen Xh.H. shumën prej 2,908.64 euro. Shpenzimet i ka kërkuar sipas tarifës së OAK.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me datë 26.12.2024, përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se pretendimet e paditësve se i takon kompensimi deri më vitin 2021, janë ta pabazuara për arsye se në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 e datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Po ashtu ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadija e paditëses është e pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi për licencim dhe kualifikim është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të saj pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 124, par.6.1 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, si dhe komunës me këtë veprim i shkaktohen shpenzime të mëdha. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe

nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund ka theksuar se e drejta e kompensimit të kualifikimit prej vitit 2017 është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së, sepse kanë kaluar mbi 3 vite. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune pranë SHFMU "Ibrahim Fehmiu", në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes provave dhe atë:

Për paditësen S.G. vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren, me numër 255/04-8, i datës 23.06.2021, sipas së cilës vërtetohet se e njëjta në këtë shkollë punon prej datës 02.10.2017 – 18.04.2021 dhe Kontrata e punës me numër 19/258, e datës 04.12.2017. Sipas licencës së mësimdhënësit me numër 100010961, shihet se validiteti i të njëjtës ka qenë 01.03.2013 – 01.03.2018, licencim i pranuar edhe përmes aktvendimit me numër 1010961, i datës 01.03.2013. Lidhur me kualifikimin e të njëjtës, gjykata është bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Gjilan, me numër 228, i datës 05.02.2015, sipas së cilës e njëjta ka përfunduar studimet themelore baqelor në drejtimin Biologji – Kimi. Ndërsa në listë të pagave vërtetohet se e njëjta në emër të kualifikimit është kompensuar në shumën prej 58.32 euro, për pagën bazë 421 euro.

Për paditësin V.J. vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren, me numër 255/04-51, i datës 23.06.2021, sipas së cilës vërtetohet se i njëjti në këtë shkollë punon prej datës 01.12.2020 – 18.04.2021 dhe Kontrata e punës me numër 19/304, e datës 02.12.2020. Sipas licencës së mësimdhënësit me numër 1030777, shihet se validiteti i të njëjtës është 18.01.2022-18.01.2027. Lidhur me kualifikimin e të njëjtit, gjykata është bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, me numër 1040, i datës 18.10.2016, sipas së cilës i njëjti ka përfunduar studimet themelore baqelor në drejtimin Shkenca Sportive. Ndërsa në listë të pagave vërtetohet se paga bazë e të njëjtit është 421 euro.

Për paditësen V.Sh. vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren, me numër 255/04-49, i datës 23.06.2021, sipas së cilës vërtetohet se e njëjta në këtë shkollë punon prej datës 18.04.2017-18.04.2021 dhe Kontrata e punës me numër 31/182. Sipas licencës së mësimdhënësit me numër 100010990, shihet se validiteti i të njëjtës ka qenë 01.03.2013 – 01.03.2018, licencim i pranuar edhe përmes aktvendimit me numër 1010990, i datës 01.03.2013. Lidhur me kualifikimin e të njëjtës, gjykata është bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prizren, me numër 840, i datës 15.09.2016, sipas së cilës e njëjta ka përfunduar studimet themelore baqelor në drejtimin Fizikë Kimi. Ndërsa në listë të pagave vërtetohet se e njëjta në emër të kualifikimit është kompensuar në shumën prej 58.32 euro, për pagën bazë 421 euro.

Për paditësen V.B.1. vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren, me numër 255/04-50, i datës 23.06.2021, sipas së cilës vërtetohet se e njëjta në këtë shkollë punon prej datës 18.04.2017-18.04.2021 dhe Kontrata e punës me numër 21/240. Sipas licencës së mësimdhënësit me numër 100020528, shihet se validiteti i të njëjtës ka qenë 20.05.2014 – 20.05.2019, licencim i pranuar edhe përmes aktvendimit me numër 1020528, i datës 20.05.2014. Lidhur me kualifikimin e të njëjtës, gjykata është bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prizren, me numër 1289, i datës 18.07.2018, sipas së cilës e njëjta ka përfunduar studimet themelore baqelor në drejtimin Programi Parashkollor. Ndërsa në listë të pagave vërtetohet se e njëjta në emër të kualifikimit është kompensuar në shumën prej 54.45 euro, për pagën bazë 393 euro.

Për paditësen V.B.2. vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren, me numër 255/04-52, i datës 23.06.2021, sipas së cilës vërtetohet se e njëjta në këtë shkollë punon prej datës 04.10.2018 – 18.04.2021 dhe Kontrata e punës me numër 5/298 e datës 28.09.2020. Sipas licencës së mësimdhënësit me numër 1028779, shihet se validiteti i të njëjtës është 24.02.2021 – 24.02.2026. Lidhur me kualifikimin e të njëjtës, gjykata është bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prizren, me numër 1364, i datës 04.04.2016, sipas së cilës e njëjta ka përfunduar studimet themelore baqelor në drejtimin Programi Matematikë Informatikë. Ndërsa në listë të pagave vërtetohet se e njëjta në emër të kualifikimit është kompensuar në shumën prej 58.32 euro, për pagën bazë 421 euro.

Për paditësen V.S. vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren, me numër 255/04-53, i datës 23.06.2021, sipas së cilës vërtetohet se e njëjta në këtë shkollë punon prej datës 18.04.2017 – 18.04.2021 dhe Kontrata e punës me numër 33/163. Sipas licencës së mësimdhënësit me numër 100011397, shihet se validiteti i të njëjtës ka qenë 01.03.2013 – 01.03.2018, licencim i pranuar edhe përmes aktvendimit me numër 1011397, i datës 01.03.2018. Lidhur me kualifikimin e të njëjtës, gjykata është bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit, me numër 423, i datës 04.07.2008, sipas së cilës e njëjta ka përfunduar studimet themelore baqelor në drejtimin Kulturë Fizike. Ndërsa në listë të pagave vërtetohet se e njëjta në emër të kualifikimit është kompensuar në shumën prej 54.45 euro, për pagën bazë 378 euro.

Për paditësen Xh.H. vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren, me numër 255/04-55, i datës 23.06.2021, sipas së cilës vërtetohet se e njëjta në këtë shkollë punon prej datës 18.04.2017 – 18.04.2021 dhe Kontrata e punës me numër 37/132. Sipas licencës së mësimdhënësit me numër 100010956, shihet se validiteti i të njëjtës ka qenë 01.03.2013 – 01.03.2018, licencim i pranuar edhe përmes aktvendimit me numër 1010956, i datës 01.03.2018. Lidhur me kualifikimin e të njëjtës, gjykata është bazuar në Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit, me numër 1141, i datës 20.07.2008, sipas së cilës e njëjta ka përfunduar studimet themelore baqelor në drejtimin Filozofik. Ndërsa në listë të pagave vërtetohet se e njëjta në emër të kualifikimit është kompensuar në shumën prej 58.32 euro, për pagën bazë 421 euro.

Andaj, Gjykata, me rastin e aprovimit të pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditësve dhe përcaktimit të lartësisë për kompensimin e diferencës në pagë për punonjësit me licencim-kualifikim, është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, e

nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33, të datës 29.08.2008.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika 3 dhe pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvjeçar, 27 % e pagës bazë.*

Gjithashtu, në bazë të kontratës kolektive të arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, në nenin 7 për licencim thuhet se: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e licencës së fituar, bazuar në UA Nr. 5/2017 Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale, si vijon: 1.1 Mësimdhënës me Licencë të karrierës 10 % e pagës bazë. 1.2 Mësimdhënës me Licencë të avancuar 10% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me Licencë mentor 15% e pagës bazë. 1.4 Mësimdhënës me Licencë meritore 15% e pagës bazë”.*

Në vendimin e Qeverisë Nr.01/33, të datës 29.08.2008, në paragrafin 4 pika 2 dhe 3, përcaktohet se *“Mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike 2 vjeçare përfitojnë 19% të pagës bazë, Mësimdhënësit me Diplomë Universitare 3 dhe 4 vite fitojnë ngritje të pagës bazë për 27%.*

Edhe në bazë të Mendimit Juridik, me nr.prot.214/2013, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues, për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën Komunën e Prizrenit.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.* Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, si dhe dispozitave tjera ligjore dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit V.J. ndërsa pjesërisht e paditësve S.G., V.Sh., V.B.1., V.B.2., V.S., dhe Xh.H. me të cilën kanë kërkuar kompensimin e pagës në emër të kualifikimit – licencimit, ashtu që ka detyruar të paditurën Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të kompensimit në pagë konform licencimit – kualifikimit të paguajë shumat dhe atë: Për paditësen S.G. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro; Për paditësin V.J. për periudhën kohore 01.12.2020-

18.04.2021, për 27% të të pagës bazë (421) euro, shumën prej 283.35 euro; Për paditësen V.Sh. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro; Për paditësen V.B.1. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro; Për paditësen V.B.2. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro; Për paditësen V.S. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro; Për paditësen Xh.H. për periudhën kohore 14.02.2019 – 18.04.2021, për 27% të pagës bazë (421) euro, shumën prej 1,383.75 euro, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 8,586.25 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë (14.02.2022), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi”*.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh afatin e parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen në afat prej 3 vitesh, konkretisht në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Andaj, gjykata vendosi që të refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë sa i përket kualifikimit, konkretisht për paditësen S.G. për periudhën 02.10.2017 - 14.02.2019, në shumën prej 1,188.51 euro, për paditësen V.Sh. për periudhën kohore 18.04.2017 - 14.02.2019, shumën prej 1,389.16 euro, për paditësen V.B.1. për periudhën kohore 18.04.2017 - 14.02.2019, shumën prej 1,458.25 euro, për paditësen V.B.2. për periudhën kohore 04.10.2018 - 14.02.2019, shumën prej 419.52 euro, për paditësen V.S. për periudhën kohore 18.04.2017 - 14.02.2019, shumën prej 1,459.72 euro dhe për paditësen Xh.H. për periudhën kohore 18.04.2017 - 14.02.2019, shumën prej 1,524.89 euro, si të parashkruar, pasi që padia është paraqitur me datë 14.02.2022.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (14.02.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të

Numri i lëndës: 2022:029128

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06889279

procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 412.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 412.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 100.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 dhe 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

C.nr.526/2022, dt.24.02.2025

Gj y q t a r i

Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.